



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 29 Prot.

Tiranë, më 09/01 /2023

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për të siguruar aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuar në qendrat e votimit.

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE
Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4

BASHKISË TIRANË
Sheshi Skënderbej

Tiranë

BASHKISË KORÇË
Adresa: Lagjia 12, Bulevardi "Shën Gjergji", Kodi Postar 7001

Korçë

BASHKISË TEPELENË
Adresa: Rruga "Ali Pashë Tepelena", Sheshi "Lord Bajron"

Tepelenë

BASHKISË SARANDË
Adresa: Rruga "Abedin Dino"

Sarandë

BASHKISË MALIQ
Adresa: Bulevardi "Rinia"

Maliq

BASHKISË DIVJAKË
Adresa: Pranë Sheshit "Santa Barbara"

Divjakë

Adresa: Rruga "Durrësit", Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

BASHKISË GRAMSH

Adresa: Sheshi "Kamber Dermushi",
Lagjia "Holta", Rruga"10 Korriku", Kati I,

Gramsh

BASHKISË PEQIN

Adresa: Bulevardi "Mustafa Gjinishi"

Peqin

BASHKISË BELSH

Adresa: Rruga Haziz Dervishi

Belsh

BASHKISË DIMAL

Adresa: Rruga "Dimal", Lagjia "18 Tetori"

Dimal

BASHKISË POLIÇAN

Adresa: Lagjia "Qendër" Poliçan, 5404,

Poliçan

BASHKISË ROSKOVEC

Adresa: Lagja Nr. 1, Qendër,

Roskovec

BASHKISË KONISPOL

Konispol

BASHKISË MIRDITË

Adresa: Rruga "Atë Gjergj Fishta"

Rrëshen

BASHKISË HIMARË

Adresa: Spile

Himarë

BASHKISË FUSHË-ARËZ

Adresa: Rruga Qendër

Fushë Arrëz

BASHKISË LIBOHOVË
Adresa: Rruga "Avni Rustemi"

Libohovë

BASHKISË KOLONJË
Adresa: Sheshi Rilindja

Kolonjë

BASHKIA PUKË
Adresa: Sheshi "Tërbuni"

Pukë

BASHKISË DELVINË
Adresa: Lagjia "Sinan Ballaci," Rruga "Nazif Hadëri"

Delvinë

BASHKISË SKRAPAR
Adresa: Lagjia "Çlirimi", Rruga "Pasho Hysi", Çorovodë

Skrapar

BASHKISË HAS
Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati Kulturës,
"Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë

Has

BASHKISË PUSTEC
Adresa: Pustec

Korçë

BASHKISË KËLCYRË
Adresa: Sheshi "Musa Fratari"

Këlcyrë

BASHKISË CËRRIK
Adresa: Lagja Nr. 2, Rruga "Bulevardi Gjinnazi 1962",

Cërrik

BASHKISË KURBIN
Adresa: Lagja Nr. 3

Laç

BASHKISË RROGOZHINË

Adresa: Lagjia Nr. 1, Rruga e "Kavajës", Blloku "12 Shtatori"

Rrogozhinë

BASHKISË LIBRAZHD

Adresa: Sheshi "Gjorg Golemi"

Librazhd

BASHKISË FINIQ

Adresa: Finiq

Delvinë

BASHKISË LUSHNJË

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes", 9001

Lushnjë

BASHKISË MEMALIAJ

Adresa: Rruga "Tafil Buzi", Godina Nr.7

Memaliaj

BASHKISË FIER

Adresa: Lagjia "Kryengritja e Fierit", Rruga "Ramiz Aranitasi"

Fier

BASHKISË ELBASAN

Adresa: Rruga "Qemal Stafa"

Elbasan

BASHKISË GJIROKASTËR

Adresa: Sheshi "Çerçiz Topulli"

Gjirokastrë

BASHKISË PATOS

Adresa: Lagjia "Naftëtari", Rruga "Unaza"

Patos

BASHKISË PRRENJAS

Adresa: Rruga "Skënderbej"

Prrenjas

BASHKISË SHIJAK

Adresa: Lagjia "Erzen"

Shijak

BASHKISË BULQIZË
Adresa: Lagjia “Minatori”

Bulqizë

BASHKISË KUÇOVË
Adresa: Blloku Nr.1, Lagjia “Tafil Skendo”

Kuçovë

BASHKISË DIBËR
Adresa: Bulevardi Elez Isufi

Peshkopi

BASHKISË VLORË
Adresa: Rruga “Zigur Lelo”

Vlorë

BASHKISË KRUIJË
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Qendër

Krujë

BASHKISË KAVAJË
Adresa: Bulevardi “Josif Buda”

Kavajë

BASHKISË DURRËS
Adresa: Sheshi “Liria”, 2000,

Durrës

BASHKISË BERAT
Adresa: Rruga “Antipatrea”

Berat

BASHKISË MALËSI E MADHE
Adresa: Koplik Qendër

Malësi e Madhe

BASHKISË VAU I DEJËS
Adresa: Rruga “Qafa e Gurit”

Vau i Dejës

BASHKISË POGRADEC
Adresa: Bulevardi “Rreshit Çollaku”

Pogradec

BASHKISË VORË Adresa: Rruga “Unaza”, Nr. 73	<u>Vorë</u>
BASHKISË MAT Adresa: Sheshi “Ahmet Zogu”	<u>Burrel</u>
BASHKISË SELENICË	<u>Selenicë</u>
BASHKISË KLOS Adresa: Klos	<u>Mat</u>
BASHKISË PËRMET Adresa: Shëtitorja “Abdyl Frashëri”	<u>Përmet</u>
BASHKISË TROPOJË Adresa: Sheshi “Azem Hajdari”, Bajram Curri	<u>Tropojë</u>
BASHKISË MALLAKASTËR Adresa: Lagjia “18 Prilli”	<u>Ballsh</u>
BASHKISË KUKËS Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Lagjia 5	<u>Kukës</u>
BASHKISË DEVOLL Adresa: Lagjia Nr.1, Rr. “24 Tetori”, Nr. 9,	<u>Devoll</u>
BASHKISË LEZHË Adresa: Lagjia “Skënderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti”	<u>Lezhë</u>
BASHKISË KAMËZ Adresa: Bulevardi “Blu”, Nr. 492	<u>Kamëz</u>
BASHKIA SHKODËR Adresa: Rruga “13 Dhjetori”, Nr. 1	<u>Shkodër</u>
BASHKIA DROPULL Adresa: Jergucat	<u>Gjirokastrë</u>

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*në vijim Komisioneri*), është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”.

Komisioneri, në ushtrim të kompetencës së parashikuar nga neni 32/1/c të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, me Urdhërin nr. 45 datë 09.04.2021, filloi procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes, lidhur me plotësimin e detyrimeve ligjore për sigurimin e aksesit fizik dhe lehtësirave të tjera në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet kombëtare, të datës 25.04.2021.

I. Procedura e ndjekur nga Komisioneri.

Me qëllim kryerjen e monitorimit të lidhur me plotësimin e detyrimeve ligjore nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, për sigurimin e aksesit fizik dhe lehtësirave të tjera, për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat e votimit, KMD i kërkoi të gjithë bashkive në Republikën e Shqipërisë¹, informacionin e mëposhtëm:

1. Numri total i qendrave të votimit, që mbulohen nga secila bashki;
2. Numri i qendrave të votimit, që plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë fizike, sipas legjislacionit në fuqi, për votuesit me aftësi të kufizuara (paraplegjikë, tetraplegjikë, të verbër dhe personat që nuk dëgjojnë);
3. Numri i qendrave të votimit, që nuk i plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë fizike sipas legjislacionit në fuqi, për votuesit që kanë aftësi të kufizuara; (paraplegjikë, tetraplegjikë, të verbër dhe personat që nuk dëgjojnë);
4. Numri i personave me aftësi të kufizuara, për secilën bashki, që do të jenë votues në zgjedhjet e datës 25 prill 2021;
5. Masat e marra për krijimin e lehtësirave të tjera për votuesit me aftësi të kufizuara si: vendparkime të posaçme për ta, sigurimi i hapësirave të nevojshme për lëvizjen e tyre brenda qendrave të votimit etj.

¹Referuar shkresës nr. 602/1 prot., datë 13.04.2021, së KMD-së, e cila iu dërgua për dijeni edhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

6. Informacion i hollësishëm mbi masat e marra për efekt të zbatimit të nenit 5, pika 1 dhe pika 3, gërma b) të Udhëzimit nr. 1, datë 05.12.2020, të KQZ-së “Pë rrcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit për përgatitjen e hartës së njësishme të vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

Në kushtet kur, vetëm një pjesë e bashkive dërguan informacionin e kërkuar, Komisioneri u bëri kujtesë për kthim përgjigje² bashkive³ të tjera, që të dërgonin të dhënat e kërkuara brenda datës 07.06.2021.

Në vijim, rezultoi se 6 (gjashtë) bashki, përkatësisht: Bashkia Sarandë, Bashkia Has, Bashkia Cërrik, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Shkodër dhe Bashkia Tropojë nuk i kthyen përgjigje shkresave të KMD-së.

Ndërkohë që, nga informacioni i administruar nga përgjigjet zyrtare rezultoi se 31 bashki kanë deklaruar se të gjitha qendrat e votimit, nën administrimin e tyre, i plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuara, si më poshtë vijojnë.

Tabela 1 – Bashkitë, në të cilat të gjitha qendrat e votimit plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuara.

Nr.	Bashkitë	Numri total i qendrave të votimit, që mbulohen nga secila bashki	Numri i qendrave të votimit, që plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë fizike për AK.
1.	Bashkia Tiranë	926	926
2.	Bashkia Korçë ⁴	164	164
3.	Bashkia Tepelenë	23	23
4.	Bashkia Divjakë	70	70
5.	Bashkia Gramsh	49	49
6.	Bashkia Urë Vajgurore ⁵	47	47
7.	Bashkia Poliçan	23	23
8.	Bashkia Roskovec	34	34
9.	Bashkia Himarë	35	35
10.	Bashkia Fushë-Arëz	16	16
11.	Bashkia Kolonjë	29	29

² Nëpërmjet shkresës nr. 672/26, datë 26.05.2021, së KMD-së;

³ Bashkitë Sarandë, Maliq, Belsh, Roskovec, Skrapar, Has, Cërrik, Librazhd, Lushnjë, Fier, Gjirokastrë, Shijak, Dibër, Durrës, Berat, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Selenicë, Përmet, Tropojë, Lezhë, Kamëz, Shkodër dhe Dropull;

⁴ Në 34 QV ka votues me AK;

⁵ Me anë të Dekretit nr. 12 067, datë 01.04.2021, të Presidentit të Republikës, Bashkia Ura Vajgurore ndryshoi emërtim në Bashkia Dimal. Gjatë shqyrtimit të çështjes, korrespondenca zyrtare me këtë bashki është mbajtur me emërtesën paraardhëse.

12.	Bashkia Pukë	20	20
13.	Bashkia Skrapar	23	23
14.	Bashkia Pustec	7	7
15.	Bashkia Këlcyrë	18	18
16.	Bashkia Rrogozhinë	53	53
17.	Bashkia Librazhd	55	55
18.	Bashkia Finiq	50	50
19.	Bashkia Patos	48	48
20.	Bashkia Përrenjas	39	39
21.	Bashkia Shijak	54	54
22.	Bashkia Bulqizë	49	49
23.	Bashkia Kuçovë	65	65
24.	Bashkia Vlorë	227	227
25.	Bashkia Malësi e Madhe	72	72
26.	Bashkia Mat	50	50
27.	Bashkia Përmet	24	24
28.	Bashkia Mallakastër	52	52
29.	Bashkia Kukës	73	73
30.	Bashkia Devoll	50	50
31.	Bashkia Kamëz	130	130

Nga të dhënat e administruara rezulton se 24 bashki nuk i ofrojnë kushtet për aksesueshmëri fizike në të gjitha qendrat e votimit. Të dhënat parashtrohen si më poshtë vijojnë:

Tabela 2 – Bashkitë, që nuk ofrojnë kushte për aksesueshmëri fizike të personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit.

Nr.	Bashkitë	Numri total i qendrave të votimit, që mbulohen nga secila bashki	Numri i qendrave të votimit, që plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë fizike	Numri i qendrave të votimit, që nuk i plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë fizike
1.	Bashkia Maliq	108	13	95
2.	Bashkia Peqin	48	38	10
3.	Bashkia Belsh	40	34	6
4.	Bashkia Konispol	16	pjesa më e madhe	pjesa më e vogël
5.	Bashkia Mirditë	49	36	13
6.	Bashkia Libohovë	9	6	3
7.	Bashkia Delvinë	23	20	3
8.	Bashkia Kurbin	74	62	12 -QV - në kate të dyta
9.	Bashkia Lushnjë	157	148	9
10.	Bashkia Memaliaj	27	26	1
11.	Bashkia Fier	222	202	20 (Në këto QV u caktuan persona për të ndihmuar personat me AK)

Adresa: Rruga "Durrësit", Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

12.	Bashkia Elbasan	222	192	30
13.	Bashkia Dibër	101	93	8 (QV në katet e dyta)
14.	Bashkia Krujë	92	89	3
15.	Bashkia Kavajë	90	7	83
16.	Bashkia Durrës	335	s'ka informacion	
17.	Bashkia Berat	119	107	12
18.	Bashkia Vau i Dejës	53	13	40
19.	Bashkia Pogradec	107	103	4 (QV në kat të dytë)
20.	Bashkia Vorë	44	shumica e QV	pakica e QV
21.	Bashkia Selenicë	42	35	7
22.	Bashkia Klos	27	17	10
23.	Bashkia Lezhë	126	79	47
24.	Bashkia Dropull	37	30	7

Lidhur me masat e marra nga këto institucione në zbatim të parashikimeve të nenit 5, pika 1 dhe pika 3, gërma b) të Udhëzimit nr. 1, datë 05.12.2020, të KQZ-së “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit për përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, Bashkitë përgjithësisht janë përgjigjur se qendrat e votimit janë në katet e para të ndërtesave publike dhe private, kanë hapësirën e nevojshme jo më pak se 30 m² për të siguruar lëvizshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, ose pranë qendrave të votimit që kanë shkallë janë ngritur rampa, qendrat e votimit kanë ndriçim të mjaftueshëm, si dhe janë siguruar vendparkime për personat me aftësi të kufizuara. Bashkia Shijak ka sqaruar gjithashtu se anëtarët e komisionit të qendrave të votimit janë trajnuar dhe kanë marrë udhëzimet e duhura nga trajnuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për t’u ardhur në ndihmë të gjithë votuesve, ku përparësi i është dhënë trajtimit të rasteve të votuesve me aftësi të kufizuara. Disa nga bashkitë që nuk kanë dhënë specifikime të sakta se cili është numri i qendrave të votimit që plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë, janë shprehur se pjesa dërrmuese e qendrave të votimit ndodhen në katet e para, ndërkohë që shkollat që janë përdorur si të tilla janë pajisur me rampa.⁶ Disa bashki japin shpjegime më të plota, ndërkohë që të tjera mjaftohen duke sqaruar se janë marrë masat përkatëse. Bashkia e Kavajës, Kukësit, Bulqizës, Kurbinit dhe e Fierit, kanë informuar se kanë vënë në dispozicion të personave me aftësi të kufizuara, personel të posaçëm për t’i ndihmuar gjatë procesit të votimit. Bashkia Kurbin ka informuar se është një nga bashkitë më të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe për pasojë janë dëmtuar edhe disa nga objektet publike, ku ishin vendosur qendrat e votimit, të cilat po rikonstruktohen. Pavarësisht kësaj, kjo bashki sqaron se janë marrë masat për caktimin e qendrave të votimit në objekte publike dhe private që plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

⁶ Referuar shkresës nr. 6082/1, datë 25.05.2021 të Bashkisë Durrës.

KMD ka kërkuar nga bashkitë, informacion edhe mbi numrin e personave me aftësi të kufizuara, duke specifikuar kategorinë e personave paraplegjik-tetraplegjik dhe persona të verbër. Në tabelën e mëposhtëme paraqiten të dhënat e dërguara zyrtarisht nga këto institucione:

Tabela 3 – Votuesit me aftësi të kufizuara sipas secilës bashki.

Nr.	Bashkitë	Numri i personave me aftësi të kufizuara/votues. (para-tetraplegjikë & të verbër)
1.	Bashkia Tiranë	18 071
2.	Bashkia Korçë	131
3.	Bashkia Tepelenë	26
4.	Bashkia Sarandë	nuk ka informacion
5.	Bashkia Maliq	920
6.	Bashkia Divjakë	212
7.	Bashkia Gramsh	223
8.	Bashkia Peqin	nuk ka informacion ⁷
9.	Bashkia Belsh	735
10.	Bashkia Urë Vajgurore	134
11.	Bashkia Poliçan	106
12.	Bashkia Roskovec	825
13.	Bashkia Konispol	88
14.	Bashkia Mirditë	140
15.	Bashkia Himarë	237
16.	Bashkia Fushë-Arëz	307
17.	Bashkia Libohovë	88
18.	Bashkia Kolonjë	288
19.	Bashkia Pukë	342
20.	Bashkia Delvinë	171
21.	Bashkia Skrapar	545
22.	Bashkia Has	nuk ka informacion
23.	Bashkia Pustec	3
24.	Bashkia Këlcyrë	38
25.	Bashkia Cërrik	nuk ka informacion
26.	Bashkia Kurbin	333
27.	Bashkia Rrogozhinë	900
28.	Bashkia Librazhd	nuk ka informacion ⁸
29.	Bashkia Finiq	94
30.	Bashkia Lushnjë	680

⁷ Bashkëlidhur shkresës nr. 681/1, datë 24.04.2021, të Bashkisë Peqin nuk është dërguar lista e personave para-tetraplegjikë dhe atyre të verbër që janë votues;

⁸ Referuar shkresës nr. 2937/1, datë 03.06.2021, të Bashkisë Librazhd numri i personave me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç është 757 persona, ndërkohë që nuk disponohen evidenca të sakta mbi numrin e votuesve që janë me aftësi të kufizuara;

31.	Bashkia Memaliaj	301
32.	Bashkia Fier	1 409
33.	Bashkia Elbasan	802
34.	Bashkia Gjirokastrë	nuk ka informacion
35.	Bashkia Patos	1089
36.	Bashkia Përrenjas	774
37.	Bashkia Shijak	205
38.	Bashkia Bulqizë	nuk ka informacion
39.	Bashkia Kuçovë	528
40.	Bashkia Dibër	1395
41.	Bashkia Vlorë	3470
42.	Bashkia Krujë	832
43.	Bashkia Kavajë	1037
44.	Bashkia Durrës	1126
45.	Bashkia Berat	1519
46.	Bashkia Malësi e Madhe	1019
47.	Bashkia Vau i Dejës	600
48.	Bashkia Pogradec	235
49.	Bashkia Vorë	125
50.	Bashkia Mat	508
51.	Bashkia Selenicë	487
52.	Bashkia Klos	446
53.	Bashkia Përmet	265
54.	Bashkia Tropojë	nuk ka informacion
55.	Bashkia Mallakastër	654
56.	Bashkia Kukës	nuk ka informacion
57.	Bashkia Devoll	1335
58.	Bashkia Lezhë	4659
59.	Bashkia Kamëz	1311
60.	Bashkia Shkodër	nuk ka informacion
61.	Bashkia Dropull	162

Përveç bashkive, që nuk i kanë kthyer përgjigje zyrtare KMD-së, në informacionin e përcjellë nga Bashkia Kukës, Bulqizë dhe Peqin, numri i personave me aftësi të kufizuara (të verbër dhe paraplegjikë dhe tetraplegjikë) nuk është raportuar. Ndërkohë që, një pjesë e konsiderueshme e bashkive të tjera i kanë raportuar me një shifër të përbashkët votuesit, që i përkasin këtyre kategorive.

- KMD iu drejtua për informacion edhe shoqatave të ndryshme⁹ që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të cilave iu kërkua që, nëse nga ana tyre disponohej informacion, si dhe raste konkrete të qendrave të votimit, të cilat nuk plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë fizike për votuesit me aftësi të kufizuara, të dërgohej informacioni

⁹ Shkresa nr. 602/2 prot., datë 14.04.2021, e KMD-së drejtuar shoqatave;

përkatës pranë Komisionerit. Shoqatat u bënë me dije se informacioni i sipërcituar mund të dërgohej në çdo kohë dhe duhet të ishte i shoqëruar me prova dhe fakte konkrete.

Në adresë të KMD-së u dërgua informacion vetëm nga Fondacioni “Së Bashku”¹⁰, ku evidentoheshin raste konkrete në disa qendra votimi në Bashkinë e Durrësit, Bashkinë e Shijakut dhe atë të Krujës, ku nuk plotësoheshin kushtet e aksesueshmërisë fizike të personave me aftësi të kufizuar. Rastet janë përcjellë nëpërmjet fotove dhe videove të ndryshme.

- Në adresë të KMD-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve¹¹ dërgoi për dijeni të KMD-së informacion lidhur me shkresën e dërguar nga Bashkia Shijak, në të cilën pasqyrohet numri i votuesve me aftësi të kufizuar që kanë ushtruar të drejtën e votës. KQZ sqaron se mbështetur në nenin 116/1, paragrafi 5, të Kodit Zgjedhor, në përfundim të numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të ZAZ-së, kutitë e materialeve të votimit dërgohen në KQZ, së bashku me kutitë e votimit të mbyllura me kod sigurie. Numri i personave që kanë ushtruar të drejtën e votës, e pasqyruar në materialet e votimit, ndodhen në kutitë e materialeve zgjedhore, të cilat hapen vetëm gjatë shqyrtimit administrativ të kërkesave ankimore. KQZ thekson faktin se listat e zgjedhësve nuk evidentojnë kategorinë e zgjedhësit nëse është apo jo PAK, ndaj edhe në rast të hapjes së kutive të materialeve zgjedhore, ky informacion nuk mund të gjendet.

II. Legjislacioni i zbatueshëm

- **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).**

Neni 14

Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

¹⁰ Rastet e përcjella nga Fondacioni Së Bashku janë trajtuar në kuadër të ankesës nr. 79, datë 29.04.2021;

¹¹ Shkresa nr. 5737, datë 11.06.2021, e KQZ-së drejtuar znj. S.L. dhe për dijeni KMD-së;

Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1

Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

➤ Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Neni 2

Përkufizimet

Në kuptimin të kësaj Konvente:

“Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar” ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës;

“Përshtatje brenda logjikës” ka kuptimin e çdo modifikimi dhe përshtajeje të nevojshme dhe të përshtatshme duke mos imponuar një barrë disproporcionale dhe të panevojshme, kur është e nevojshme në raste të veçanta, për tu siguruar personave me aftësi të kufizuar gëzimin apo ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut njësoj si pjesa tjetër e popullsisë;

Neni 3

Parime të përgjithshme

Parimet e kësaj Konvente do të përfshijnë:

- a. Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;
- b. Mosdiskriminimin;

- c. Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;
- d. Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;
- e. mundësi të barabarta;
- f. Akses;
- g. Barazi ndërmjet burrave dhe grave;
- h. Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, si edhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetin e tyre.

Neni 5

Barazia dhe mosdiskriminimi

1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.
2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në çdo rrethanë.
3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimin e diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arsyeshëm.
4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur *de facto* barazinë e personave me aftësi të kufizuar nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente.

Neni 9

Aksesi

1. Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerë të kenë akses në ambientet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në facilitete apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat do të përfshijnë evidentimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave ndaj aksesit do të zbatohen ndër të tjera:
 - (a) Në ndërtesa, rrugë, transport dhe facilitete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambientet e punës;

(b) Informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës.

2. Gjithashtu, shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për:

- a) Të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me aksesin ndaj objekteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruar për publikun;
- b) T'u siguruar që subjektet private të cilat ofrojnë objekte dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruar për publikun të marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesit për personat me aftësi të kufizuar;
- c) Të ofruar tranim për aktorët e interesit lidhur me problemet që kanë të bëjnë me aksesin për personat me aftësi të kufizuar;
- d) T'u siguruar që ndërtesat dhe objektet e tjera publike të përmbajnë shenja në gjuhën Braille dhe në forma lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme;
- e) Të siguruar forma asistence direkte dhe të ndërmjetme, duke përfshirë guida, lexues dhe interpretë profesionistë të gjuhës së shenjave, për të mundësuar aksesin në ndërtesa dhe objekte të tjera publike;
- f) Të inkurajuar forma të tjera të përshtatshme të asistencës dhe mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuar për tu siguruar që ata të kenë akses në informacion;
- g) Të nxitur aksesin e personave me aftësi të kufizuara ndaj e informacioneve të reja dhe sistemeve të teknologjive e reja të komunikimit, duke përfshirë dhe internetin;
- h) Të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e teknologjive dhe sistemeve të aksesueshme të informacionit dhe komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të aksesueshme me një kosto minimale.

Neni 19

Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet

Shtetet Palë në këtë Konventë njohin të drejtën e barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuar për të jetuar në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët dhe do të marrin masat e duhura dhe efektive për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht këtë të drejtë dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e tyre të plotë në komunitet, përfshirë dhe duke u siguruar që:

- a) Personat me aftësi të kufizuar të kenë mundësinë për të zgjedhur vendbanimin e tyre, ku dhe me kë do të jetojnë, njësoj si të tjerët dhe të mos jenë të detyruar të jetojnë në një mënyrë të vecantë të caktuar jetese;

- b) Personat me aftësi të kufizuar të kenë akses ndaj një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, shërbimesh rezidenciale dhe shërbimesh në komunitetet dhe të parandalojnë izolimin dhe veçimin e tyre nga komuniteti;
 - c) Shërbimet dhe objektet komunitare për popullatën në përgjithësi të jenë të disponueshme në baza të barabarta për personat me aftësi të kufizuar dhe t'ju përgjigjen nevojave të tyre.
- **Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.**

Neni 12

Përbërja dhe funksionimi i KQZ-së

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor.

Neni 49

Organi që harton listën e zgjedhësve

1. Çdo zyrë e gjendjes civile është përgjegjëse për përgatitjen e listave të zgjedhësve të zonave të qendrave të votimit nën juridiksionin e saj, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra nga ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile ka akses të plotë në RKGjC mbi përbërësit zgjedhorë të shtetasve të njësisë vendore, individualisht dhe në tërësi, dhe ka përgjegjësi të plotë për saktësinë e administrimit dhe ndryshimit të tyre.
2. Zyra e gjendjes civile, pas fillimit të procesit të hartimit të listave, i raporton një herë në muaj kryetarit të njësisë vendore për numrin dhe llojin e ndryshimeve që janë kryer në përbërësit zgjedhorë, shtimin apo pakësimin e numrit të zgjedhësve, si dhe i dorëzon për shpallje listën e zgjedhësve.
3. Listat e hartuara nga zyra e gjendjes civile shpallen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka në juridiksion zyrën përkatëse të gjendjes civile. Çdo faqe e listës së publikuar përmban nënshkrimin dhe vulën e përgjegjësit të gjendjes civile. Në rast mospërmbushjeje brenda afatit të këtij detyrimi nga ana e kryetarit, zyra e gjendjes civile njofton menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila shpall listat.

Neni 50

Drejtimi metodologjik dhe mbikëqyrja e procesit të hartimit të listave

.....

3.KQZ-ja mbikëqyr procesin e hartimit të listave të zgjedhësve, administrimin e zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi. KQZ-ja i kërkon informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësisë të qeverisjes vendore. Për shkeljet e konstatuara dhe për mosdhënie të informacionit, KQZ-ja u vendos sanksione drejtuesve të institucioneve përgjegjëse, në përputhje me këtë Kod.

Neni 62

Caktimi i zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit

1. Zona e qendrës së votimit duhet të jetë brenda një territori kompakt dhe të pashkëputur gjeografik dhe numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk duhet të jetë më i vogël se 300 dhe më i madh se 1,000 zgjedhës.
2. Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës.
3. Kufijtë ekzistues të zonës së qendrës së votimit nuk ndryshojnë, me përjashtim të rastit kur bëhet i domosdoshëm ndryshimi për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. KQZ-ja, me udhëzim të veçantë, numërton zonat e qendrave të votimit në mënyrë unike në shkallë vendi.
4. Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.
5. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 4 të nenit 51 të këtij Kodi, cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.
6. Kur një zonë qendre votimi ka më shumë se 1,000 zgjedhës dhe lista është ndarë sipas nenit 51 të këtij Kodi, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore vendos krijimin e qendrës shtesë të votimit brenda së njëjtës zonë. Në këtë rast qendra e re e votimit ngrihet, për sa është e mundur, në të njëjtën godinë me qendrën ekzistuese të votimit dhe numërohet sipas sistemit unik kombëtar të numërimit të qendrave të votimit.

.....

9. Jo më vonë se 10 ditë nga përcaktimi i qendrës së votimit, sipas këtij neni, kryetari i njësisë vendore është i detyruar të njoftojë KQZ-në. Njoftimi për vendndodhjen shoqërohet edhe me planimetrinë, llojin e objektit dhe informacione të tjera të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së.

10. Mbi bazën e informacionit të marrë nga kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në zbatim të këtij neni, KQZ-ja krijon dhe përditëson hartën e zonave të qendrave të votimit, si dhe krijon bazën e të dhënave mbi vendndodhjet e qendrave të votimit. Përfaqësuesit e partive politike të akredituara në KQZ kanë të drejtë të njihen në çdo Kohë me to.

➤ **Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.**

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji janë:

- a) përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët;
- b) përcaktimet për garantimin e jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët;
- c) përcaktimet për mënyrën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, nevojave për mbështetje të personave me aftësi të kufizuara dhe mënyrat se si do të sigurohet kjo mbështetje.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;
- b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.

.....

3. “Pengesat” nënkuptojnë:

a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;

b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar;

c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike;

ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

4. “Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit, njëlloj si të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

5. “Mjetet ndihmëse” është një pajisje ose një sistem produktesh që mund të modifikohet ose të përshtatet dhe të përdoret për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara për kapërcimin e pengesave dhe për të përmirësuar mundësitë e tyre për pjesëmarrje në mënyrë të barabartë.

6. “Mohim i përshtatjes së arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

.....

9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët. 10. “Përfshirje” është pjesëmarrja efikase dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale mjedisore, infrastrukturore dhe institucionale, të cilat shkaktojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta persona.

.....

11. "Përshtatje e arsyeshme" është modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vendosur barrë të tepruar, për t'u garantuar personave me aftësi të kufizuara gëzimin ose ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 4

Parimet

Parimet bazë të këtij ligji janë:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;
- b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta;
- c) autonomia e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes së personave me aftësi të kufizuara;
- d) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve;
- dh) përfshirja, nëpërmjet së cilës mundësohet pjesëmarrja e duhur dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës;
- e) pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara;
- f) qasja në dy drejtime, për të integruar në maksimum të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin e zakonshëm dhe për t'i kufizuar në minimum çështjet që duhen trajtuar më vete;
- g) ë) realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerr masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Neni 5

Jetesa e pavarur

1. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.

2. Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht:

- a) në strehim të përshtatshëm dhe të jetojnë ku dhe me kë të dëshirojnë;
- b) në shkollat e zakonshme dhe të studiojnë në shkollën për të cilën dëshirojnë;
- c) në një treg gjithëpërfshirës të punësimit; ç) në qendra kulturore, sportive dhe qendra të tjera publike;
- d) në shërbime shoqërore;
- dh) në qendra aftësimi dhe rehabilitimi;
- e) në shërbime shëndetësore përmes infrastrukturës së përshtatshme;
- ë) në transport;
- f) në komunikim dhe informacion;
- g) në jetën politike dhe publike, si zgjedhës dhe të zgjedhur;
- gj) në aktivitete biznesi e sipërmarrjeje.

Neni 6

Shërbimet për një jetesë të pavarur

1. Jetesa e pavarur mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen: asistencë personale, pajisjet e mjetet teknike mbështetëse, shërbimet e aksesueshmërisë, përfshirë transportin, përshtatja e arsyeshme dhe, atëherë kur është e nevojshme, vendimmarrja e mbështetur.
2. Shërbimet që mundësojnë jetesën e pavarur kanë minimalisht karakteristikat e mëposhtme:
 - a) fokusohen në nevojat e individit dhe në zgjedhjet e tij personale;
 - b) mbulojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha sferat e jetës, përfshirë sferën e punës, arsimit dhe aktiviteteve shoqërore, profesionale dhe të kohës së lirë, si dhe të gjitha dëmtimet e nevojat për ndihmë që rrjedhin nga dëmtimi/aftësia e kufizuar;
 - c) krijohen në formën e një shërbimi kontraktual ndërmjet individit me aftësi të kufizuara dhe ofruesit të shërbimit;
 - ç) janë nën kontrollin e personit me aftësi të kufizuara në cilësinë e konsumatorit;
 - d) kanë procedura të qarta dhe transparente ofrimi;
 - dh) përfshijnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të dhënë udhëzime;
 - e) japin mundësinë për personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë ndihmë që të mësojnë gradualisht si të japin udhëzime;
 - ë) synojnë zhvillimin e plotë të personalitetit të personave me aftësi të kufizuara në respekt të diversitetit.

3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

➤ **Ligj nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar.**

Neni 2

Në kuptimin e këtij ligji:

1. “Paraplegjik” nënkupton çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme.
2. “Tetraplegjik” nënkupton çdo person, që vuan nga paraliza e katër anësive si pasojë e dëmtimit të palcës kurizore nga shkaqe të ndryshme dhe i klasifikuar si i tillë me vendimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

Neni 3

Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive.....

Neni 4

Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes.

➤ **Ligj nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar,**

Neni 1

Përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësore janë të paaftë për punë në kushte normale.

Neni 3

Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç

kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta.

➤ **Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (në vijim ligji nr.10221/2010)**

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3

Përkufizimet

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

9. “*Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme, që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të

drejtave dhe lirive themelore, të njohura në kuadrin ligjor kombëtar, për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 20

Të mirat dhe shërbimet

1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.
2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:
 - a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku;
 - b) mundësi për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;
 - c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;
 - ç) mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor;
 - d) sistemimin në një vend ku ofrohet strehim;
 - dh) shitjen ose dhënien me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera;....
3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.
4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit...”

Neni 22

Statusi

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 32

Kompetencat

1. Komisioneri ka kompetencë:

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; ë) t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;

- **Vendim nr. 1074, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara".**

Kreu I

Rregullime të Përgjithshme

1. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukturale për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.
2. Janë pengesa në komunikim: a) vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim e dëgjim; b) vështirësitë në komunikim që kanë personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar.
3. Janë pengesa infrastrukturale: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.
4. Ky vendim e shtrin zbatimin mbi:
 - a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara;
 - b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet

rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët;

c) mjetet e transportit publik;

ç) mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik.

Kreu II

Rregulla të Posaçme

1. Niveli i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara garantohe në përputhje me kërkesat teknike, në çdo rast.
2. Çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.
3. Subjektet, që ofrojnë shërbim publik, garantojnë proces komunikimi dhe informimi për individët me vështirësi shikimi ose plotësisht të verbër, duke botuar në gjuhën braille dhe/ose me shkrim të zmadhuar dhe/ose në formatin audio materiale të lidhura drejtpërdrejt me interesat parësorë të këtij grupi njerëzish, duke parashikuar në mënyrë progresive edhe buxhetin përkatës të nevojshëm për përmbushjen e kësaj përshtatshmërie. Shërbimet e ofruara, ku përparësi kanë shërbimet e ofruara nga institucione të ligjit dhe tatim-taksave, institucione të arsimit dhe botimit, të shëndetësisë, të punësimit e të transportit, respektojnë kërkesat e përshkruara në këtë vendim.
10. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bashkëpunim me bashkitë, realizojnë në raste të caktuara, sidomos gjatë periudhave zgjedhore, procese komunikimi konsultimi dhe këshillimi plotësisht të aksesueshme për individët e verbër, duke ofruar edhe formate të përshtatura me audio dhe/ose forma të tjera të porositura nga komuniteti i njerëzve që nuk shikojnë.

.....

19. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bashkëpunim me bashkitë, realizojnë në raste të caktuara, sidomos gjatë periudhave zgjedhore, procese komunikimi konsultimi dhe këshillimi në distancë, me ndihmën e teknologjisë (telefon /television/internet) si dhe nëpërmjet videokonferencave.

- **Vendimi nr.1503, datë 19.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar””.**

Neni 1

Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.
2. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.
3. Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:
 - të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë
 - godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit;
 - ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;
 - ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.

Neni 2

Përshtatja e objekteve ekzistuese

1. Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe të llogariten të gjitha mundësitë për përshtatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.
2. Çdo ndërtesë duhet të pajiset, nën kujdesin e administratorit publik apo privat të ndërtesës, me një sistem thirrjesh që të aktivizojë një shërbim ndihme në mënyrë të tillë që t'u lejojë personave me aftësi të kufizuara lëvizjen ose ndijimin e shërbimit me zë.
3. Në objektet e banimit publike/private dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun, aplikohen rregullat dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore.
4. Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.

Neni 2

Përkufizime

1. Barrierat arkitektonike janë:
 - a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar të përhershme ose të përkohshme;
 - b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve dhe pjesëve përbërëse;
 - c) mungesat e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve dhe të burimeve të rrezikut për këdo dhe në veçanti për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.
2. Personat me aftësi të kufizuara (PAK) janë individët, me kufizim të aftësive në lëvizje, si pasojë e dëmtimeve fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilët në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.
3. Person me lëvizje të vështirësuar - është personi i cili ka pengesa të përkohshme ose të përhershme gjatë lëvizjes, të cilët kanë prirje të shmangen për më shumë se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse;
4. Mjet ndihmës për PAK - janë mjetet ndihmëse për orientim dhe mjetet ndihmëse për lëvizje;
5. Mjet ndihmës për orientim - është shkopi dhe qeni shoqërues;
6. Mjet ndihmës për lëvizje - është karroca për PAK-në, shkopi, paterica dhe mjete të tjera ndihmëse për ecje;
7. Pengesa - është pengesë komunikuese dhe orientuese e cila e pengon personin me aftësi të kufizuar ose ia pamundëson arritshmërinë, lëvizjen, qëndrimin dhe lëvizjen gjatë kryerjes së punës;
8. Eliminimi i barrierave - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.
9. Elementet e eliminimit të barrierave - janë pjesë të objekteve ndërtimor ose pajisje, të cilat sigurojnë eliminimin e barrierave, të përcaktuara me këtë rregullore. Këto elemente ose pajisje janë: rampa, shkallë, ashensor, platforma vertikale ngritëse, platforma të pjerrëta lëvizëse palosëse, detaje në hapësirat hyrëse, doreza e derës dhe dritares, pulti, tabela e shpalljeve, plani orientues për lëvizje në ndërtesë, semafori, pajisje komunikimi, hapësira dhe pajisje WC, banja, kuzhinë, dhoma, klasa, ambiente pune, banimi/apartamenti, kafeneja, restoranti, gardëroba, kabina dushi, pishina, vendet në tribuna, kabina telefonike, tekstofoni, bankomati, instalimet elektrike, stacioni dhe

personi, vend parkingu, sipërfaqja publike për këmbësor, kalimi për këmbësor, ishulli për këmbësorë dhe udhëkryqi.

10. Elementet e detyrueshëm për eliminimin e barrierave - janë elementet për projektim dhe ndërtim me anë të të cilave përcaktohet madhësia, vetitë, instalimet dhe pajisjet e tjera të ndërtesës për sigurimin e eliminimit të pengesave në lëvizje, qëndrim dhe punë të PAK-së, në të njëjtin nivel me personat tjerë.
11. Shenjat dalluese - janë shenjat me të cilat përcaktohen elementet detyruese për përshtatje.
12. Banesa që përshtatet lehtë - është banesa e cila sipas nevojës mund të përshtatet për eliminimin e barrierave pa ndikuar në pjesët kryesore të përdorimit të saj.
13. Lajmërimi me sinjalizime të dritës - është lajmërimi dhe paralajmërimi për personat që nuk dëgjojnë dhe ata me dëgjim të dobët me ndihmën e sinjalizimit të dritës.
14. Lajmërimi zanor - është lajmërimi dhe paralajmërimi nëpërmjet zërit për personat që nuk shohin dhe/ose kanë shikim të dobët.
15. Sinjalizimi zanor - është sinjalizimi i cili ndihmon personat që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për orientim në hapësirë.
16. Harku induktiv ose rrethi transmetues - është instalim, i cili vendoset për të larguar zhurmën nga rrethi dhe për të përmirësuar kualitetin e zërit.
17. Ndhimëse komunikuese - është pajisje, e cila i mundëson personave të cilët shfrytëzojnë aparatën dëgjues për pranimin e sinjaleve dëgjuese pa pengesa.
18. Tekstofon - është telefon i përshtatur për persona që nuk dëgjojnë dhe/ose me dëgjim të dobësuar, që mundëson komunikimin me shkrim ndërmjet dy bashkëbiseduesve.
19. Përpunimi relievor - është përpunimi përfundimtar me reliev i sipërfaqes së ecjes.
20. Vija relievore drejtuese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes së personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të drejtimit të lëvizjes përcakton atë me ndërrimin e strukturës relievore me gjerësi së paku 40 cm.
21. Vija relievore paralajmëruese - është përpunim me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për rrezikun nga komunikacioni.
22. Fusha relievore paralajmëruese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për paralajmërim të personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar të ndryshimit të nivelit të lëvizjes.

- **Vendim nr. 276, datë 12.5.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021–2025”.**

1.1.Objektivi Specifik: Realizimi i Aksesueshmërisë në Mjedisë për Personat me Aftësi të Kufizuara

1.1.1.Ngritja dhe bëria funksionale e Task-Forcës me qëllim konsultimin e propozimin e politikave për aksesueshmërinë , të programeve e projekteve si dhe monitorimin e zbatimit të standardeve të aksesueshmërisë me përfaqësim nga të gjitha institucionet.

1.1.4 Propozimi i përmirësimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor (VKM, rregullore, udhëzime, manuale etj.), me qëllim forcimin e aplikimit të kërkesave dhe standardeve për aksesueshmërinë në mjedisë, si edhe të masave ndëshkuese në rast të moszbatimit të tyre.

1.1.5. Ndërgjegjësimi, informimi dhe trajnimi në lidhje me rekomandimet e Konventës së OKB-së për personat me aftësi të kufizuara, legjislacionin shqiptar mbi kërkesat dhe standardet e aksesueshmërisë së mjedisit, standardet evropianë në lidhje me mjedisin e përshtatur , për antarët e TaskForcës dhe stafet e nevojshme të të gjitha institucioneve , stafin pedagogjik në shkollat e formimit profesional, universitete, etj. subjektet projektuese dhe zbatuese në fushën e ndërtimeve dhe infrastrukturës rrugore; pronarët/administratorët e bizneseve private, ofrues të shërbimeve etj.

1.1.6 Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit me personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, në lidhje me të drejtat e tyre bazuar në legjislacionin shqiptar, në rekomandimet e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si edhe dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare.

1.1.8. Promovimi përmes fushatave të komunikimit/ndërgjegjësimit praktikat pozitive në zbatimin dhe aplikimin e kërkesave dhe standardeve të aksesueshmërisë në mjedisë për personat me aftësi të kufizuara.

- **Udhëzimi nr. 1, datë 05.12.2020, i KQZ-së, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit për përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.**

Neni 5

Kriteret teknike dhe pajisjet e qendrës së votimit

1. Mjedisin e qendrës së votimit, si rregull duhet të plotësojë kriteret e mëposhtëme:

- a) Të jetë me sipërfaqe jo më të vogël se 30 m²;
- b) Të jetë sa më afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;
- c) Të ketë ndriçim të mjaftueshëm;
- d) Të jetë në katet e para të objekteve;

3. Kryetari i njësisë së vetqeverisjes vendore, merr masa për:

.....

- c) Krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara;

III. Analizë vlerësuese.

Ushtrimi i plotë dhe i barabartë i të gjitha të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është një përparësi kombëtare që kërkon politikë aktive, të qëllimshme dhe të qëndrueshme, si dhe veprime të përbashkëta të autoriteteve qendrore dhe lokale, institucioneve të pavarura dhe e sidomos të organizatave përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara.

Politikat e hartuara dhe të ndërmarra ndaj personave me aftësi të kufizuara ndikojnë në mënyrë të njëjtë në secilën fushë të jetës së tyre, prandaj edhe implementimi i tyre kërkon vëmendje maksimale dhe të kujdesshme të të gjithë institucioneve, me qëllim që të përdorin mjete të efektshme dhe të mirëkoordinuara.

Niveli ende i ulët i njohjes së kuadrit ligjor ekzistues dhe i ndërgjegjësimit institucional dhe publik, krijon idenë e përgjithshme që aksesueshmëria në mjedise të identifikohet vetëm me vendosjen e një rampe në hyrje të ndërtesës, e cila në shumë raste rezulton jashtë standardeve. Më pak vëmendje i kushtohet aplikimit të elementeve të aksesueshmërisë për personat që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim.

Nga të dhënat e administruara nga 55 bashkitë që kanë dërguar informacion zyrtar në adresë të Komisionerit, rezulton se nga 31 prej tyre deklarojnë se kanë siguruar akses fizik për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe personat e verbër në të gjitha qendrat e votimit.

Bashkia Tiranë është bashkia më e madhe në Republikën e Shqipërisë, e cila ka raportuar se i ka plotësuar kriteret e aksesueshmërisë fizike për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe ata të verbër në të gjitha qendrat e votimit nën administrimin e saj. Për sa më sipër, KMD vë në dukje faktin se gjatë hetimit administrativ të ankesës nr. 82, datë 04.05.2021, të znj. S. L. në cilësinë e Drejtores Ekzekutive të Fondacionit “Së Bashku”, ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vijim KQZ) dhe Bashkisë Tiranë, ka rezultuar e kundërta. Me anë të vendimit nr. 142, datë 13.08.2021, të dhënë për, Komisioneri është shprehur me konstatim diskriminimi të

shtetases S. L. dhe shtetasve, të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, në formën e mohimit përshtatjes së arsyeshme, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar, pasi nuk plotësoheshin kriteret e aksesueshmërisë për individët me AK në qendrat e votimit, të kësaj bashkie.

Njëkohësisht, edhe në vendimin nr.41, datë 28.02.2022, KMD është shprehur me konstatim diskriminimi, në lidhje me ankesën Nr.79 regj, datë 29.04.2021, të paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”, kundër Bashkisë Durrës, Bashkisë Krujë, Bashkisë Shijak dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vijim KQZ), në të cilën pretendohet diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara në kuadër të ushtrimit të të drejtës së votës për zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021. Në këtë ankesë pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e bashkive të sipërcituara, pasi ka rezultuar se edhe këto bashki paraqesin problematika të njëjta me atë të Bashkisë Tiranë. Përveç sa më sipër, vlen të theksohet fakti se edhe nëpërmjet vendimit nr. 142, datë 03.08.2021¹², KMD është shprehur për konstatim diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar ndaj shtetases S. L. dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, në formën e mohimit përshtatjes së arsyeshme, nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar, si dhe ka kërkuar që nga ana e Bashkisë Tiranë të merren të gjitha masat e nevojshme, për të garantuar elementët e aksesueshmërisë në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe në udhëzimet përkatëse. Ndërkohë që, Komisioneri ka kërkuar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të kontrollojë dhe të monitorojë, brenda kompetencave të veta, zbatimin e kriterëve, sa i takon personave me aftësi të kufizuara, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të ardhshme.

Në të këtë kontekst, KMD gjykon se edhe të dhënat e raportuara nga bashkitë e tjera duhen vlerësuar me rezervë. Përveç kësaj, Komisioneri ka konstatuar se masat e marra nga bashkitë, në asnjë rast nuk konsistojnë në krijimin e lehtësirave për kategorinë e personave të verbër, të cilët kanë gjithashtu nevojë për aksesueshmëri fizike siç janë vendosja e shiritave dhe parmakëve të posaçëm në ambientet qendrave të votimit.

24 (Njëzetëekatër) bashki të tjera kanë raportuar se jo të gjitha qendrat e votimit kanë aksesueshmëri fizike për personat me aftësi të kufizuar, pasi rregullimi i një shtate të tillë është realizuar vetëm për një pjesë të tyre.

Në rastin konkret, KMD vlerëson se kemi të bëjmë me mohimin e një përshtatjeje të arsyeshme, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme, që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi

¹² Vendimi nr. 142/2021, i KMD-së është dhënë mbi ankesën nr. 82, datë 04.05.2021, të S. L., në cilësinë e Drejtores Ekzekutive të Fondacionit “Së Bashku”, ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vijim KQZ) dhe Bashkisë Tiranë.

dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore, të njohura në kuadrin ligjor kombëtar. Pavarësisht se në Udhëzimin nr. 1, datë 05.12.2020, i KQZ-së, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit për përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021” është përcaktuar qartësisht se njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të marrin masa për të siguruar lehtësira për votimin e personave me aftësi të kufizuara, këto masa nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe të plota nga ana e tyre.

Përveç sa më sipër, KMD vë në dukje faktin se përveç përfundimeve të dala gjatë hetimit të tij administrativ për këtë çështje të iniciuar kryesisht, rezultate të njëjta janë evidentuar edhe nga verifikimet e kryera pas zgjedhjeve kombëtare në Shqipëri, të datës 25.04.2021, nga OSBE ODIHR, apo edhe nga komitete apo institucione të tjera, të cilat janë reflektuar në raportet e tyre për zgjedhjet kombëtare të vitit 2021, apo edhe për zgjedhjet e mëparshme në Shqipëri.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK)¹³ ka miratuar Vëzhgimet përmblyëse mbi raportin fillestar të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të 503-të, të mbajtur më 16 shtator 2019¹⁴. Në lidhje me të drejtën e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike, Komiteti shprehet i shqetësuar për mungesën e aksesueshmërisë në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, në veçanti aksesueshmërinë e qendrave të votimit dhe materialeve të votimit, për personat me aftësi të kufizuara.¹⁵ KDKPAK rekomandon marrjen e masave për të lejuar akses fizik të papenguar në votim, vendosjen e mekanizma të sigurt për të garantuar fshehtësinë e votimit dhe të sigurohet disponueshmëria e materialeve dhe informacioneve të tjera zgjedhore në formate të aksesueshme, duke përfshirë gjuhën e shenjave, Braille dhe leximin e thjeshtë, në përputhje me Komentin e Përgjithshëm të Komitetit nr. 2¹⁶.

Në Raportin Përfundimtar të Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të datës 25 prill 2021, konstatohet nga vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it se: “Shumica e QV-ve të vizituara nuk ishin pa pengesa për personat me aftësi të kufizuara fizike.”¹⁷

Në Raport-Monitorimin – Zgjedhjet Parlamentare në Shqipëri 2021, të Avokatit të Popullit¹⁸ është konstatuar se nuk përmbushen kriteret për aksesueshmërinë fizike të personave me

¹³ Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) është një strukturë e ngritur (në bazë të Nenit 34 të KEDNJ) për të monitoruar zbatimin e detyrimeve të KEDNJ, nga Shtetet Anëtare.

¹⁴ https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD%2fC%2fALB%2fCO%2f1&Lang=en

¹⁵ Si më sipër, paragrafi 47.

¹⁶ Si më sipër, paragrafi 48.

¹⁷ Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, varianti në gjuhën shqipe, faqe 28. Link: <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>

¹⁸ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raport%20monitorimi%20per%20zgjedhjet%20vendore%202021.pdf> (f.6);

aftësi të kufizuara. Në këtë Raport-Monitorimi citohet: *“Institucioni i Avokatit të Popullit iu drejtua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me dy kërkesa të përsëritura për dhënien e një informacioni të detajuar, lidhur me masat e marra, apo që do të ndërmerreshin, për krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara. Në përgjigjen e dhënë nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me shkresën nr.4153/1 datë 18.05.2021, veç sqarimeve që lidhen me parashikimet ligjore në caktimin e qendrave të votimit na u konfirmua se, të gjitha qendrat e votimit janë vendosur në katet e para të godinave për të lehtësuar pikërisht aksesin e tyre edhe nga personat me aftësi të kufizuara. Po kështu, në përgjigje thuhet se, në ato qendra votimi ku referuar listës së zgjedhësve ka zgjedhës të tillë dhe ku infrastruktura e godinës e ka lejuar, janë vendosur edhe rampa për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në vazhdim të përgjigjes jemi informuar se, në rastet kur kryetarët e qeverisjes vendore, kanë njoftuar për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit, qendrat e votimit përkatëse janë pajisur me shabllonin e alfabetit braile. Si përmbushje e detyrimeve ligjore në këtë drejtim, përmenden edhe pajisja e çdo qendre votimi me dhomën e fshehtë në dimensione të tilla që mundëson lehtësisht votimin edhe nga personat me aftësi të kufizuara si dhe përfshirjen e interpretimit të gjuhës së shenjave në të gjitha spotet e fushatës elektorale dhe sensibilizuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nga monitorimi në terren i zbatimit të masave të premtuara që do të merreshin, rezultoi se kishte shumë problematika. Më konkretisht, nga ana e grupeve tona të monitorimit në ditën e zgjedhjeve, rezultoi që veç të tjerash kishte qendra votimi që ishin në katet e dyta të godinave”.*

E drejta e votës është e drejtë thelbësore dhe jo privilegj. E drejta e votës universale kërkon që të gjithë qytetarët të kenë të njëjtat mundësi për të marrë pjesë në jetën politike të vendit, siç parashikohet në marrëveshjet ndërkombëtare dhe në të drejtën kombëtare. Aksesueshmëria e plotë në çdo fazë të procesit të votimit në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara duhet të jetë rregulli dhe jo përjashtimi. Aksesueshmëria është një kërkesë e pakushtëzuar dhe nuk mund të zbehet duke referuar tek “barra disproporcionale” pasi është parakusht për gëzimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në jetën politike dhe shoqërore në pozitë të barabartë me të tjerët. Në praktikë, aksesin e personave me aftësi të kufizuara në të drejtat e tyre në baza të barabarta me ato të personave pa aftësi të kufizuara shpesh mbetet një mendim i dëshiruar që rezulton i pamjaftueshme, gjë që përkthehet në pjesëmarrje dukshëm më të ulët të personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor dhe i marginalizon më tej këtë pjesë të shoqërisë.

Nga hetimi i kryer në të gjitha Bashkitë e Republikës së Shqipërisë, Komisioneri ka konstatuar se realizimi i aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat e votimit nuk është realizuar plotësisht nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ka nevojë për rregullime të mëtejshme.

IV. Konkluzione

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur ligjvënësi ka miratuar akte ligjore dhe nënligjore, të cilat përmbajnë parashikime të rëndësishme, lidhur me sigurimin e aksesueshmërisë fizike të personave me aftësi të kufizuar dhe përshtatjes së arsyeshme për këta individë, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrim ligjor të sigurojnë kushtet e përshtatshme në qendrat e votimit, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të kenë mundësi të barabarta për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar, sikurse individët e tjerë që nuk ndodhen në gjendjen e tyre. Në këtë kontekst, KMD vë në dukje edhe përgjegjësinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të kontrolluar dhe monitoruar këtë proces brenda tagrave që i ka dhënë ligji.

Sa më sipër, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim rregullimin e situatës dhe bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”,

REKOMANDON


1. Marrjen e masave të nevojshme nga ana e të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet për pushtetin lokal që do të zhvillohen në 14 maj 2023, për të garantuar elementët e aksesueshmërisë fizike dhe për të siguruar përshtatjen e arsyeshme në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të marrin të gjitha masat e nevojshme, para dhe gjatë zgjedhjeve për pushtetin lokal, që do të zhvillohen në 14 maj 2023, në këto aspekte:
 - Hartimi i planeve të veprimit nga çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, lidhur me hapat që do të ndërmerren për krijimin e infrastrukturës përkatëse në qendrat e votimit për sigurimin e aksesueshmërisë fizike të personave me aftësi të kufizuar dhe mbi procesin e votimit për këta persona, sipas llojit të aftësisë së kufizuar;
 - Hartimi i listave të sakta të personave me aftësi të kufizuara, që janë zgjedhës, ku të evidentohet edhe lloji i aftësisë së kufizuar. Këto lista t’i përcillen edhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 2 (dy) muaj para zhvillimit të zgjedhjeve vendore;
 - Të mbahet dhe evidentohet si statistikë e rregullt, numri i personave me aftësi të kufizuar që kanë votuar në zgjedhje;
 - Të trajtohen me prioritet të gjithë votuesit me aftësi të kufizuar në procesin e votimit;

- Qendrat e votimit pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore të caktohen vetëm në katet e para të godinave, që do të përdorën për këtë qëllim, të kenë hapësirë jo më pak se 30 m², të kenë ndriçimin e nevojshëm, si dhe të jenë pranë qendrës administrative të qytetit, në mënyrë që të sigurohet aksesueshmëria fizike e personave me aftësi të kufizuara.
 - Të krijohet hapësira dhe lartësia e nevojshme në vendin e votimit¹⁹, brenda qendrës së votimit, për personat me aftësi të kufizuara, duke krijuar përshtatshmëri për ta gjatë procesit të votimit;
 - Të kryhet verifikimi paraprak i të gjithë qendrave të votimit nga strukturat përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, lidhur me plotësimin e kritereve të aksesueshmërisë dhe votimit për personat me aftësi të kufizuara;
3. Marrjen e masave nga ana e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, për të kontrolluar dhe monitoruar, brenda kompetencave të tij, zbatimin e kritereve të sipërcituara, mbi aksesueshmërinë fizike në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve për pushtetin lokal që do të zhvillohen në 14 maj 2023.
4. Marrjen e masave nga ana e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve para dhe gjatë zgjedhjeve për pushtetin lokal që do të zhvillohen në 14 maj 2023, lidhur me aspektet e mëposhtëme:
- të miratojë udhëzime të posaçme, lidhur me procesin e votimit të personave me aftësi të kufizuara dhe të zhvillojë trajnime të posaçme për administratën zgjedhore lidhur me procesin e votimit nga personat me aftësi të kufizuara;
 - të marrë masa për të mbledhur të dhëna në lidhje me numrin e personave me aftësi të kufizuara të regjistruar në zgjedhje dhe atyre që kanë votuar në zgjedhje, sipas llojit të aftësisë së kufizuara.
 - Përgatitjen dhe shpërndarjen në kohë optimale të fletëve të votimit për personat e verbër;
 - Kryerjen e verifikimit dhe monitorimit paraprak të qendrave të votimit në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, lidhur me plotësimin e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuara, të vendit të votimit dhe në tërësi të këtyre qendrave;
 - Publikimi në media dhe faqen zyrtare të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, i spoteve publicitare që informojnë mbi procesin zgjedhor dhe mënyrën e votimit për personat që nuk dëgjojnë;

¹⁹ Vendi, ku votuesit plotësojnë fletët e votimit;

Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijani, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij Rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Robert GAJDA

